



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:108042
Datë: 25.09.2024
Numri i dokumentit: 06209470

Ac.nr.7665/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, dhe gjyqtarëve Fatmir Baloku e Besnik Feka - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.B., nga fshati ..., komuna e Suharekës, të cilin me autorizim e përfaqëson av.B.K., nga Suhareka, kundër të paditurit Sh.B., nga fshati ..., komuna e Suharekës, për shkak të lirimit të paluajtshmërisë nga njerëzit dhe sendet, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - dega Suharekë, C.nr.513/21, të datës 25.10.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur më datën **25.09.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurit Sh.B., fshati..., komuna e Suharekës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - dega Suharekë, C.nr.513/21, i datës 25.10.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.513/21, të datës 25.10.2022, në pikën *I (një)* të dispozitivit, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit M.B., ashtu që e ka obliguar të paditurin Sh.B., që pjesën prej 40m2 në ngastrën kadastrale 2286-3 në vendin e quajtur Rashica zk Studençan ta liron nga njerëzit dhe sendet e të njëjtën t'ia dorëzon në pronësi dhe posedim faktik paditësit. Duke u detyruar i padituri që mos ta pengon paditësin në shfrytëzimin e lirë të ngastrës kadastrale të lartcekur, sipas pikave kadastrale duke filluar: nga ana Veriore: Nga pika 9 deri te pika 10 gjatësia është 0.57m, Nga pika 10 deri te pika 11 gjatësia është 13.48, Nga pika 11 deri te pika 12 gjatësia është 3.86m, Nga pika 12 deri te pika 13 gjatësia është 1.02m, Ana Lindore: Nga pika 13 deri te pika 14 gjatësia është 5.11m, Nga pika 14 deri te pika 15 gjatësia është 1.51m, Nga pika 15 deri te pika 16 gjatësia është 23.80m, Nga pika 16 deri te pika 17 gjatësia është 11.53m, Nga pika 17 deri te pika 18 gjatësia është 6.54m,

Nga pika 18 deri te pika 19 gjatësia është 12.54m, Nga pika 19 deri te pika 20 gjatësia është 15.57m, Nga pika 20 deri te pika 21 gjatësia është 7.53m, Nga pika 21 deri te pika 22 gjatësia është 8.08m, Nga pika 22 deri te pika 23 gjatësia është 12.19m, Nga pika 23 deri te pika 24 gjatësia është 3.65m, Ana Jugore: Nga pika 24 deri te pika 1 gjatësia është 34.65m. Ana Perëndimore: Nga pika 1 deri te pika 2 gjatësia është 6.17m, Nga pika 2 deri te pika 3 gjatësia është 15.30m, Nga pika 3 deri te pika 4 gjatësia është 12.58m, Nga pika 4 deri te pika 5 gjatësia është 12.39m, Nga pika 5 deri te pika 6 gjatësia është 2.69m, Nga pika 5 deri te pika 7 gjatësia është 28.18m, Nga pika 7 deri te pika 8 gjatësia është 15.91m, Nga pika 8 deri te pika 9 gjatësia është 17.50m, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. E ka obliguar palën e paditur që paditësit t'ia kompenzon shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 1,100.00 euro, në afat prej 15 ditësh, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. E ka hedhur poshtë si të palejuar parashtrësën e të paditurit e parashtruar në këtë gjykatë më 18.10.2022, për rihapjen e procedurës së provave.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar ankesë, duke atakuar të njëjtin për shkak të *shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, vendimit mbi shpenzimet procedurale, me propozim që Gjykata e Apelit ta prish aktgjykimin e ankimuar dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, apo i njëjti të ndryshohet dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pabazuar.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur pala paditëse, duke propozuar që aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, e në mbështetje të nenit 194 dhe 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se

- Ankesa e të paditurit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi me datën 02.06.2021, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri që paditësit t'ia lirojë pronën nga njerëzit dhe sendet po ashtu edhe t'ia dorëzojë në posedim pjesën e parcelës kadastrale kontestuese, më gjërësisht si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka mbajtur shqyrtimin kryesor dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.513/21, të datës 25.10.2022, me të cilin në tërësi e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi gjykata ka theksuar se e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, pasi që nga provat e administruara ka vërtetuar faktin se ngastra kadastrale evidentohet

në emër të paditësit, e që në teren është konstatuar se një pjesë të kësaj paluajtshmërie e shfrytëzon i padituri, nga ku gjykata e shkallës së parë ka përfunduar se sipas dispozitave ligjore të nenit 93 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (LPDTS), paditësi si pronar ka të drejtë të kërkojë lirim të paluajtshmërisë nga poseduesi jo pronarë, pasi që i paditura këtë paluajtshmëri e shfrytëzon pa asnjë bazë ligjore.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurit se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Poashtu i pathemeltë është pretendimi ankimor edhe sa i përket gjendjes faktike të vërtetuar dhe të drejtës materiale të zbatuar, pasi që kjo gjykatë me shikimin e shkresave të lëndës konstaton se me provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar fakti se paditësi është pronarë i vetëm dhe i pakontestueshëm i ngastrës kontestuese nr.2286-3 ZK Prizren, në sipërfaqe të përgjithshme prej 3149 m², të cilën, e ka fituar në bazë të kontratës mbi shkëputjen e bashkësisë familjare e vërtetuar nga Gjykata Komunale në Suharekë me VR.nr.1225/8. Poashtu nga provat e nxjerra dhe nuk ka qenë kontestuese edhe nga i padituri se një pjesë të kësaj paluajtshmërie e shfrytëzon i padituri pa asnjë bazë ligjore, andaj gjykata e shkallës së parë mbi bazën e kësaj gjendje faktike të konstatuar në vend e ka detyruar të paditurin që ta bëjë lirim dhe dorëzimin e kësaj ngastre lëndore, me çka Gjykata e Apelit e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë, ngase gjendja faktike e konstatuar është në pajtim me të drejtën materiale të referuar nga gjykata, nga e cila edhe ka rrjedhur përfundimi meritor i kësaj çështje kontestuese.

Në rastin konkret në mënyrë të pakontestueshme është provuar fakti se paditësi është pronarë i paluajtshmërisë kontestuese në gjithë sipërfaqen e saj, të regjistruar në regjistrin për të drejtat në pronë e paluajtshme, dhe e drejta e tij sa i përket kërkesës për lirim dhe dorëzimin e pronës është dëshmuar me titull të vlefshëm pronësie, e cila titullarit të saj i jep autorizim që atë ta mbajë, ta përdorë dhe të disponojë me sendin, e që në rastin konkret paditësit edhe autorizim që të kërkojë dorëzimin e sendit në posedim nga poseduesi jo pronar.

Poashtu edhe pretendimi ankimor sa i përket rihapjes së procedurës së provave me propozimin që të lejohet dëgjimi i dëshmitarëve, kolegji i Apelit gjeti se në bazë të nenit 402 dhe

428 par.2 të LPK-së, palët kanë për detyrë më së vonë në seancën përgatitore ti parashtrojnë faktet dhe ti propozojnë të gjitha provat, ndërsa gjatë shqyrtimit kryesor mund ti parashtrojnë vetëm nëse e bëjnë të besueshme se pa fajin e tyre nuk kanë mundur t'i paraqesin, respektivisht propozojnë në seancën përgatitore. Në shkresat e lëndës shihet se paditësi nuk i ka propozuar dëshmitarët respektivisht nuk i ka dhënë emrat e tyre deri pas përfundimit të shqyrtimit kryesor. Andaj kolegji i Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka hedhur poshtë si të palejuar parashtresën e të paditurit për rihapjen e procedurës së provave.

Përfundimisht, kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime ishin të paqarta dhe nuk kishin të bëjnë me këtë çështje, dhe nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7665/22, datë 25.09.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari
Arsim Hamzaj